

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Pune**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

"Ndertimi i linjes 20kV ajrore N.St Palasë – Tuneli Llogarasë".

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

65300000-6 - Shperndarje e energjise elektrike dhe sherbime te lidhura me kete

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

56,077,199 (pesëdhjetë e gjashtë milion e shtatëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e nëntë)  
Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

*b. Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 3.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):** me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

*2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë xhiro minimale vjetore të realizuar, për periudhën e 3 (tre) viteve të fundit financiare, te paktën 50,000,000 (pesëdhjete milion) Leke.*

*Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.*

*Si prove per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje vertetim nga Administrata Tatimore ku te tregohet xhiroja vjetore per vitet e siperpermendura dhe kopje të certifikuara të bilanceve ku të paktën në dy bilance, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kerkesa e mesiperme eshte ne perpjestim dhe e lidhur ngusht me objektin e kontrates. Duke marre ne konsiderate sasine e mallrave dhe punimet objekt procedure prokurimi, kerkohet qe OE ofertues te paraqese se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomiko - financiare per ta realizuar ate ne kohe dhe ne perputhje me specifikimet teknike te kerkuara. OE ofertues duhet te kete disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me kete qellim, eshte argumentuar se vlera e xhiros duhet te jete ne masen 50,000,000 (pesedhjete milion) Leke.

---

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

*2.3.1 Operatori ekonomik ofertues për të provuar përvojën e mëparshme, duhet të ketë realizuar të paktën:*

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 25,000,000 (njëzet e pesë milion) Leke dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;*

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më të vogël se 100,000,000 (njëqind milion) Leke.

*Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.*

*Si dëshmi për përvojën e mëparshme, OE Ofertues duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.*

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, OE Ofertues duhet të paraqesë si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.*

#### **Shenim:**

- **Kontrata te ngjashme, do te kosiderohen punimet per ndertime linja elektrike te tensionit te mesem dhe te larte kabllore nentokesore.**
- **Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, sipas parashikimeve te nenit 88, pika 3, te VKM Nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar, kushti i përcaktuar më sipër në lidhje me kontratat e ngjashme plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marre ne konsiderate sasine dhe cilesine e mallrave objekt procedure prokurimi, si dhe punimet e kerkuara, eshte menduar se vlera e kerkuar qe OE ofertues te kete bere me kontrata te ngjashme, te jete sipas parashikimeve ligjore. Ne kete menyre, AK ka sigurine dhe besueshmerine qe OE ofertues mund te realizoje kontraten objekt prokurimi pa patur pengesa te ndryshme qe do te ndikonin ne ecurine e punes se AK.

Gjithashtu eshte percaktuar lloji i kontratave te ngjashme, te cilat ne menyre te pergjithshme duhet te kene ngjashmeri me objektin e procedures se prokurimit.

2.3.2 *Operatori ekonomik ofertues duhet te jete i pajisur me licence profesionale, ne fushen e zbatimit te punimeve, leshuar nga organet kompetente, e cilat te permbajne kategorite e meposhtme:*

<i>Kategoria NP-1</i>	<i>Punime germimi ne toke</i>	<i>Klasifikim B</i>
<i>Kategoria NP-11</i>	<i>Ndertime per N/stacionet, kabinat e transformatoreve linja e TN e te mesem dhe shperndarjen e energjise</i>	<i>Klasifikimi B</i>

***Shenim :*** *Ne rast pjesmarrjeje te nje Operatori ekonomik te huaj, ky i fundit, Licencen e mesiperme me kategorite e pershkruara, duhet ta kete te njehsuar prane organeve perkatese ne Republiken e Shqiperise sipas legjislacionit te saj ne fuqi.*

**Argumentimi:** Keto kategori punimi janë në përputhje me zërat e preventivit paraprak dhe objektin e prokurimit, janë proporcionale dhe te lidhura ngusht me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Kjo kërkesë lidhur me licencën profesionale të shoqërisë është në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 6/a, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.3 *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht punonjesit si me poshte vijon:*

- *Si drejtues teknik te perfshire ne licencen e shoqerise te pakten 1 (nje) inxhinier elektrik.*
- *Gjithashtu si pjese e stafit te tij ofertuesi pervec inxhinierit te mesiperm duhet te kete dhe 1 (nje) inxhinier elektrik*

*Inxhinieret e mesiperm duhet te jene te siguruar dhe te figurojne ne listepagesat perkatese E-Sig per 6 (gjashte) muajt e fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates.*

*Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje: kontratat individuale te punes, shoqeruar me diplomat perkatese te inxhinierëve te mesiperm, si dhe listepagesat per periudhen e kerkuar.*

*Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.*

*Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.*

**Argumentimi:** Kërkesa për inxhinieriët e sipërcituar është në përpjestim dhe e lidhur me objektin e kontratës, respekton edhe parimin e mosdiskriminimit dhe është kërkesë minimale e mundur të plotësohet nga cdo OE që ka në objektin e vet tregëtar keto lloj niveli punimesh. Keto kërkesa për kualifikim janë në përputhje me pikën 6, të Nenit 39 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe Nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”. Këto kërkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.4 *Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë me shkrim se inxhinieret e pershkruar në pikën 2.3.3 për kualifikim janë të pa angazhuar në kontrata të tjera dhe, në rast se shpallen fitues për këtë procedurë, do të qendrojnë në objekt gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve.*

*Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vertetësinë e deklaratës.*

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur me qëllim për garantimin se OE ofertues do të realizojë kontratën objekt procedure prokurimi me prioritet dhe pa vonesa. Realizimi i kësaj kontrate do të bëhet në përputhje me normat e sigurisë së Autoritetit Kontraktor, me stakime e nevojshme të koordinuara dhe për këtë qëllim duhet që OE ofertues ta realizojë atë me angazhim të plotë të stafit të tij.

2.3.5 *Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka fuqinë punëtore të nevojshme minimalisht 20 (njëzet) punonjës me kohë të plotë pune, për ekzekutimin e objektit të prokurimit, Punonjësit duhet të jenë të siguruar të pakten për 3 (tre) muajt e fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës.*

*Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë listpagesat E-Sig të punonjesve të sipërcituar.*

*Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.*

*Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.*

**Argumentimi:** Në lidhje me numrin e fuqisë mesatare punëtore të siguruar, duke patur parasysh volumet e punëve objekt kontrate, natyrën dhe vlerën e kontratës, ky numër punonjësish është proporcional dhe i lidhur me aftësinë zbatuese, me qëllim realizimin në kohë dhe me sukses të kontratës.

Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës. Numri i punonjesve është perlllogaritur duke patur në konsideratë shtrirjen gjeografike të linjës objekt punimi, si dhe volumin e punës për realizimin me sukses të kontratës.

Kjo kërkesë është në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 6/ç, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.6 *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë minimumi 8 (tetë) punonjes, të pajisur me kartela personale të sigurimit teknik, të leshuar nga shoqëri të akredituara në bazë të ligjit nr. 8734, datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike” i ndryshuar.*

*Lidhur me këto pike operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë:*

- i) listpagesat E-Sig të punonjesve të sipërcituar si dhe*
- ii) kartelat përkatëse të vlefshme të sigurimit teknik.*

*Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr.8.*

*Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.*

**Argumentimi:** Në lidhje me kërkesën për personelin e pajisur me kartelat e sigurimit teknik, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë dhe të paraqesë kartelat përkatëse të punonjësve që do të kryejnë punimet objekt kontrate. Një numer i tillë të siguruarish është kërkuar pasi punimet objekt procedure prokurimi kërkojnë punonjës të kualifikuar dhe të aftë, që të punojnë sipas kërkesave të sigurisë në punë për të shmangur rrezikun për jetën, shëndetin dhe çdo problem tjetër, gjatë zbatimit të kontratës.

Punonjësit që do të realizojnë këto kontrate, për arsye të natyrës teknike të saj dhe kushteve të punës në linjat e tensionit të lartë, duhet të respektojnë rregulloren e sigurimit teknik elektrik, bazuar në dispozitat ligjore përkatëse për punimet mbi 1000 Volt, në lartësi, me heqje dhe pa heqje tensioni.

Kjo kërkesë është në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 6/c, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.7 *Operatori ekonomik ofertues duhet të kenë në stafin e Tij, 1 (një) punonjes që të disponojë certifikatë të trajnimit si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” i ndryshuar.*

*Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.*

*Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.*

**Argumentimi:** Persa i perket kerkeses per nje punonjes te trajnuar dhe te pajisur me certifikate si pergjegjes per sigurine dhe shendetin ne pune, argumentohet se eshte i nevojshem te qendroje ne kantierin e punimeve per te ndjekur ecurine e punes se punonjesve te OE ofertues dhe te jete i gatshem ne rastin e paraqitje se kushteve te rrezikshme qe mund te ndodhin gjate zbatimit te kontrates objekt prokurimi, ne perputhje me Ligjin Nr. 10237, date 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, i ndryshuar.

Keto kërkesa janë në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 6/c, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.8 *Operatori ekonomik ofertues per përmbushjen e kontratës duhet te dëshmoj se ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike te nevojshme, si me poshte vijon:*

<b>Nr.</b>	<b>Mjetet</b>	<b>Sasia</b>
1	<i>Kamion me vinc</i>	<i>4 cope</i>
2	<i>Eskavator per hapje kanali</i>	<i>4 copë</i>
3	<i>Set karrakulla per shtrirjen dhe terheqjen e kablllove</i>	<i>4 cope</i>
4	<i>Kit komplet veglash pune per specialist linjash</i>	<i>4 copë</i>
5	<i>Preres asfalti</i>	<i>2 copë</i>
6	<i>Rul njeshes asfalti</i>	<i>1 copë</i>
7	<i>Asfaltshtruese</i>	<i>1 copë</i>
8	<i>Terameter per matjen e rezistences se tokezimit</i>	<i>1 copë</i>
9	<i>Mjete mbrojtese</i>	
	<i>a. Kokore</i>	<i>25 cope</i>
	<i>b. Fikse Zjarri</i>	<i>5 cope</i>
	<i>c. Tabela Sigurimi Teknik</i>	<i>8 cope</i>
	<i>d. Kuti Ndhime e shpejt</i>	<i>4 cope</i>

*Si deshmi per plotesimin e kesaj pike operatori duhet te disponoje:*

- 1. Per mjetet, makinerite dhe pajisjet ne pronesi te paraqitet akti i pronesisë (kontrata shitblerje, fatura tatimore e shitjes ose fatura e zhdoganimit etj.)*
- 2. Per mjetet, makinerite dhe pajisjet me qira të paraqitet kontratë qiraje si dhe akti i pronesisë së qiradhënsit sipas percaktimit te bere me lart.*
- 3. Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin (leje qarkullimi akt kolaudimi, siguracion, taksat vjetore, leje transporti dhe çertifikaten e pronesisë se mjetit) dhe foto ku te duket qarte targa e mjetit.*
- 4. Makinerite e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera. Për këtë të paraqitet një deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese se makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë deklaruar në një procedurë tjetër tenderimi në të cilën nuk është shpallur ende fituesi.*
- 5. Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku pranon se Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar.*

*Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.*

*Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.*

**Argumentimi:** Mjetet dhe pajisjet teknike te vendosura si kërkesë për tu plotësuar nga OE, janë të domosdoshme për punimet gjate realizimit te kontrates objekt procedure prokurimi, për realizimin e punimeve që do të kryhen. Kjo kërkesë është në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 6/d, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

*2.3.9 Operatori ekonomik ofertues qe do te realizoje kete kontrate, duhet te jete i pajisur dhe te paraqese certifikatat perkatese te vlefshme te ISO, te leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit, te akredituara nga DPA, ose organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, si me poshte:*

- ✓ ISO 9001: për Sistemin e menaxhimit të cilësisë, qe ka lidhje me objektin e prokurimit.*
- ✓ ISO 14001: për Sistemin e menaxhimit të cilësisë së mjedisit, qe ka lidhje me objektin e prokurimit.*
- ✓ ISO 45001: për Sistemin e menaxhimit të sigurisë ne pune, qe ka lidhje me objektin e prokurimit.*
- ✓ ISO 50001: per menaxhimin e energjise*



**Argumentimi:** Në lidhje me kërkesën që OE ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e standarteve si ISO, është menduar se ky është një kriter i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës si dhe në propozicion me to, me qëllim garantimin e realizimit në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standarteve ndërkombëtare, të objektit të kontratës.

**Certifikata për sistemin e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:** është sot referimi i njohur në nivel ndërkombëtar, për certifikimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë të kompanive të të gjithë sektoreve dhe të gjithë përmasave. Ky kriter kërket nga AK me qëllim për të vërtetuar cilësinë e shërbimit dhe të garantojë realizimin në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standardeve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

**Certifikata e menaxhimit të cilësisë së mjedisit ISO 14001:** e kërkuar nga AK garanton se OE ofertues është i certifikuar për produkte dhe punime të cilat nuk demtojnë mjedisin dhe nuk e ndotin atë dhe që janë konform standardeve ndërkombëtare të cilësisë.

**Certifikata për Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë ISO 45001:** është vendosur si kriter kualifikues për operatorët ekonomik ofertues sepse ka të bëjë me sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, e cila është me një rëndësi të vecantë për kryerjen e kësaj kontrate. OE ofertues që do të realizojë kontratën objekt procedure prokurimi duhet të kryejë punimet objekt procedure prokurimi dhe kjo kategori licence minimizon rreziqet që mund të shfaqen gjatë realizimit të kësaj kontrate.

**Certifikatë për Sistemin e menaxhimit të Energjisë ISO 50001:** është e nevojshme si kriter kualifikues, pasi lidhet me natyrën e kontratës, veprimtarinë dhe përdorimin e pajisjeve për të cilat duhet të ketë një siguri që nuk shpërdorojë energjinë e nevojshme gjatë realizimit të punimeve. Me anë të këtij certifikimi, identifikohen dhe menaxhohen rreziqet që lidhen me furnizimin e ardhshëm të energjisë, mundësohet matja dhe monitorimi i përdorimit të energjisë për të identifikuar se ku të përmirësohet efikasiteti. Po ashtu do të përmirësohet performanca e përgjithshme për të ulur konsumin e energjisë, etj.

Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 79, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

#### *2.3.10 Për listën e mëposhtme të artikujve*

- *Kabell XLPE 20kV AL (sipas specifikimeve teknike)*

*operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë për materialet e mësipërme:*

*Certifikatat e cilësisë, Autorizim nga prodhuesi/distributor, skeden teknike/katalogun e pajisjeve të lartpërmendura si dhe test reportet për pajisjet e lartpërmendura.*

**Argumentimi:** Ky kriter vendoset referuar Urdhërit të Brendshëm të Administratorit të OSSH SH.A “Për energjizimin e rrjetit të Shpërndarjes së energjisë elektrike i cili realizohet nga aplikanti në zbatim të rregullores për lidhjet e reja në sistemin e Shpërndarjes” Nr. 7 datë 23.03.2023 dhe nenit 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 ku përcaktohet “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”

2.3.11 *Ne funksion të plotësimit të Shtojcës 8 “Formulari përmbledhës i vetedeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet të japë të dhëna të qarta si Emer, Mbiemër, Ates, Amesi, Datëlindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje të skanuar të dokumentit të identifikimit (shqiptar ose të huaj), për Administratorin/Administratores të shoqërisë, Ortakun/Ortakët e shoqërisë, përfaqësues të ndryshëm të posaçem të shoqërisë, drejtues të ndryshëm të shoqërisë.*

**Argumentimi:** Ky kriter vendoset referuar njoftimit të përbashkët Nr. 1155 prot, datë 01.02.2019, të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe të Ministrisë së Drejtësisë Nr. 1001/1 prot, datë 01.02.2019, sipas parashikimeve të nenit 76/1, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Autoriteti Kontraktor ka detyrimin e verifikimit të personave të cilët janë në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik.

Per këtë arsye, verifikimi i këtyre personave kërkon të dhëna të sakta si emër, mbiemër, atesi, amësi, vendlindje, datëlindje e numrin personal të personi.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Specifikimet teknike janë hartuar nga OSSH sh.a Qender duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për punimet objekt procedure prokurimi, duke perlogaritur sasitë e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.*

**Njesia prokurimit:**

*Arjola Danaj*  
*Lulzim Kopaci*  
*Ninela Jashari*